

Njoftimi i përqendrimit me të cilin Mavie Nekst GmbH, Vjenë Austria do të fitojë kontrollin mbi Cura Domo Holding GmbH, Shveçat Austri

(lënda nr. 08-101/2024)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 08.07. 2024, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilën Mavie Nekst GmbH, me seli në Rothschildplatz 4, 1020, Vjenë, Austri, një shoqëri e lidhur e Grupit UNIKA, planifikon të marrë shumicën e aksioneve dhe kontrollin e vetëm të Cura Domo Holding GmbH, me seli në Mulgase 13, 2320, Shveçat, Austri.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit

Mavie Nekst (më parë Sanus Eks GmbH (*Sanus X GmbH*) është një shoqëri e lidhur e Grupit UNIKA ("UNIKA"). UNIKA është një grup shoqërish i udhëhequr nga UNIKA Inshurans Grup AG (*UNIQA Insurance Group AG*), Austri që ofron produkte dhe shërbime sigurimi kryesisht në Austri, Evropën Qendrore dhe Lindore.

UNIKA është e pranishme në Maqedoninë e Veriut përmes dy ndërmarrjeve- bijë, UNIKA SHA Shkup dhe UNIKA Lajf SHA Shkup.

Unika SHA Shkup ka selinë e saj në Bulevardin Ilinden 1, Shkup Karposh, Republika e Maqedonisë së Veriut, me NUAS 5896100, me aktivitet të regjistruar - sigurim jo-jetë.

Unika Lajf SHA Shkup ka selinë e saj në Bulevardin Ilinden 1, Shkup - Karposh, Republika e Maqedonisë së Veriut, me NUAS 6712339 me aktivitet të regjistruar - sigurim jete.

Cura Domo Holding GmbH është një biznes familjar i mesëm në Austri. Ofron shërbime në fushën e kujdesit 24-orësh në shtëpi, shtëpive të kujdesit (ndihmë në jetën e përditshme) dhe menaxhimit të objekteve.

Cura Domo Holding GmbH nuk ka ndërmarrje-bijë në Maqedoninë e Veriut.

Sipas parashtresës, tregu përkatës i produkteve janë tregjet për ofrimin e shërbimeve të kujdesit në shtëpi, një treg për ofrimin e shërbimeve të kujdesit në shtëpi dhe një treg për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të objekteve.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

16.07.2024

Shkup

